



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 01.10.2013
Nr. 0204-1239

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, Nr. 400-181444, të pranuar me datën 27.09.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, Ligjin Nr. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare, Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 400-181444 ,të miratuar me datë 26.09.2013 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik.

- Vendim Nr. 400-181444, për dhënien e pajisjeve në shfrytëzim NPL " Hortikultura" SHA në Prishtinë.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 01.10.2013
br. 0204-1239

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik opštine Priština
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine opštine Priština

Predmet: Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Priština , br. 400-181444,
primljeno dana 27.09.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbe Vlade 02/2011 o odgovornim administativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 400-181444 ,odobreno dana 26.09.2013 od strane Skupštine opštine Priština , **POTVRĐUJE** zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka br. 400-181444, za davanje sredstva na koristi NPL " Hortikultura" SHA Priština .

Sa poštovanjem.

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,

Kopije: Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.09.2013, miratoi këtë

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PAJISJEVE NË SHFRYTËZIM NPL "HORTIKULTURA" SHA
NË PRISHTINË

I.

Miratohet Vendimi për dhënie e pajisjeve në shfrytëzim ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura" SHA, në Prishtinë.

II.

Pajisjet e dhëna në shfrytëzim sipas pikës I të këtij vendimi, janë:

1. Kamion dizell - EU - ECE R24 35HK/25 - 30Kw, marka CITY RANGER 2250, viti i prodhimit 2013, numri i shasisë UHM2250A013A01820, pesha bartëse 900 - 1000 kg, shpejtësia e lëvizjes 20 - 30 km/h, me pajisjet përcjellëse:
 - a) 1 pajisje për largimin e borës, pesha bartëse 60 - 70 kg, me gjerësi të pastrimit 1.0 - 1.5 m,
 - b) 1 pajisje për hedhjen e kripës, pesha bartëse 70 - 75 kg, kapaciteti 220 - 260 litra,
 - c) 1 pajisje për hedhjen e borës, pesha bartëse 150 - 180 kg, me gjerësi të pastrimit 1 - 1.2 m,
 - d) 1 pajisje për thithjen e pluhurit dhe gjethëve, me dy brusha 1 - 1.3 m , me tri brusha 1.5 - 1.8 m , me katër brusha 2 - 2.3 m, kapaciteti i rezervarit 100 - 120 litra.
2. Kamion dizell, marka IVECO - DAILY 35S11D, 2287CCM, 78KW, ngjyrë e bardhë, 7 ulëse, pesha bartëse 1796 kg, viti i prodhimit 2013, numri i shasisë ZCFC3571605969813.

Faqe 1 nga 2

III.

Dhënia e pajisjeve të cekura në pikën II të këtij vendimi, bëhet për 15 vjet.

IV.

Qëllimi i dhënies së pajisjeve në shfrytëzim, të cekura në pikën I të këtij vendimi, është ngritja e cilësisë në ofrimin e shërbimeve për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike, pastrimin e borës nga sipërfaqet publike dhe krasitjen e drurëve.

V.

NPL "Hortikultura" SHA, është e obliguar që pajisjet e dhëna në shfrytëzim t'i mirëmbajë në gjendje të rregullt dhe, pas kërkesë së Komunës, t'i kthejë në posedim të saj.

VI.

Kushtet tjera të dhënies në shfrytëzim do të rregullohen me marrëveshje të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe NPL "Hortikultura" SHA.

VII.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtoria e Financave dhe e Pronës.


VIII.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 400 - 181444, më 24.09.2013

KRYESUESI I KUVENDIT
Saqi Hamiti, ecc. i dipl.



Faqe 2 nga 2